



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA
GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS RAHOVEC

Numri i lëndës: 2019:119347
Datë: 19.06.2024
Numri i dokumentit: 05835407

C.nr.822/2023

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, e përbërë nga gjyqtari Betim Behluli, me bashkëpunëtorin profesional Armond Qmega, në çështjen juridike të paditësit – F.K nga fshati Kramovik, Komuna e Rahovecit i mitur, ku të miturin F.K e përfaqëson përfaqësuesi ligjor i ati i tij F1.K, ndërsa paditësin, përfaqësuesi i autorizuar avokati R.H nga Rahoveci, kundër të paditurës B, lidhur me kompenzimin e dëmit, vlera e kontestit 2,000.00 €, me datë 19.06.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

Padia e paditësit – F.K nga fshati Kramovik, Komuna e Rahovecit i mitur, ku të miturin F.K e përfaqëson përfaqësuesi ligjor i ati i tij F1.K, ndërsa paditësin, përfaqësuesi i autorizuar avokati R.H nga Rahoveci, e ushtruar pranë kësaj gjykate, kundër të paditurës B, lidhur me kompenzimin e dëmit, KONSTATOHET E TËRHEQUR.

Lënda si e kryer ti deponohet arkivit të gjykatës.

A r s y e t i m

Paditësi paditësit – F.K nga fshati Kramovik, Komuna e Rahovecit i mitur, ku të miturin F.K e përfaqëson përfaqësuesi ligjor i ati i tij F1.K, ka ushtruar padinë kundër të paditurës B, lidhur me kompenzimin e dëmit.

Përfaqësuesi i autorizuar i paditësit me parashtrësë të veçantë e ka tërhequr padinë.

Andaj kjo gjykatë e duke u mbështetur në dispozitat e nenit 261 paragrafi 1 dhe 4 të Ligjit për Procedurën Kontestimore të Kosovës, ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi, duke konsideruar se padia e paditësit është tërhequr.

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA RAHOVEC
C.nr.822/2022, më 19.06.2024

B. Profesional
Armond Qmega

Gjyqtari
Betim Behluli

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesa e veçantë.